



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Në mbështetje të nenit 21, 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, Komuna e Gjakovës merr këtë:

Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 034/01-14069
Data/Datum 13.07.2023
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

Nr.39-VA/2023

Datë: 13/07/2023

V E N D I M

Aprovohet kërkesa për qasje në dokumente publike nga Lëvizja Vetëvendosje, duke i ofruar qasje të plotë në listën e ekonomive familjare, subjekteve afariste dhe pronave bujqësore që janë dëmtuar nga përmbytjet.

Arsyetim

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Komuna e Gjakovës, ka pranuar një kërkesë nga Lëvizja Vetëvendosje, për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje të plotë në listën e ekonomive familjare, subjekteve afariste dhe pronave bujqësore që janë dëmtuar nga përmbytjet..

Pas pranimit të kërkesës, ZQDP ka shikuar për gjetjen e këtyre dokumenteve dhe pas gjetjes së tyre, të njëjtat i dorëzohen palës kërkuese.

Në këtë drejtim, pas shqyrtimit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në kompetencën e saj, Komuna e Gjakovës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, përmes zyrtarit për QDP të Komunës së Gjakovës, mund të paraqesë ankesë në Shtyllën për Qasje në Dokumente Publike të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data në të cilën i është dorëzuar vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kërkuesit: Lëvizja Vetëvendosje - Gjakovë
- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Zyrtarit për QDP – z. Artan Haraqia
- Arkivit të Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini


Kryetar i Komunës së Gjakovës

